



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
MBI KARTËN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 118, datë 19.09.2011
Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 214, datë 28.12.2017
Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 81, datë 29.06.2020

Neni 1
Objekti

Karta e Auditimit të Brendshëm është një dokument zyrtar i cili përcakton qëllimin, autoritetin, dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky dokument përforcon pozicionin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm brenda njësisë publike, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësisë së auditimit të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, pronë dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit/Bordit drejtues (në rastet kur një organ i tillë ekziston) dhe titullari i njësisë publike kanë të drejtën për aprovimin përfundimtar të Kartës së Auditimit të Brendshëm.

Neni 2
Baza Ligjore

Bazë ligjore për këtë rregullore është Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **Autoriteti** është Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare;
- b) **Bordi** është Bordi i Autoritetit;
- c) **Kryetari** është Kryetari i Bordit të Autoritetit;

- d) **Karta** është Karta e Auditimit të Brendshëm që përshkruan: Statusin organizativ të njësisë së auditimit të brendshëm; Qëllimin, misionin dhe objektin e punës së auditimit të brendshëm; Pavarësinë dhe rregullimet ligjore që sigurojnë pavarësinë; Rolin dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm, të drejtuesit dhe audituesve të saj dhe mënyrën se si realizohen ato; Autoritetin e auditimit të brendshëm; Përgjegjshmërinë, linjat e raportimit të drejtuesit të njësisë, mënyrat dhe format e raportimit; Standardet e praktikave të auditimit të përcaktuara në Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të kësaj veprimtarie;
- e) **Njësia e auditimit të brendshëm** është e përbërë nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Specialistët auditues. Përgjegjësi i Auditimit të Brendshëm raporton te Bordi lidhur me veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm, te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv lidhur me veprimtarinë administrative të njësisë. Specialisti Auditues raporton te Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit. Objekti i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm është kryerja e auditimit të brendshëm financiar dhe të drejtimit sipas Ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Kartës së Audituesit të Brendshëm” dhe “Kodit të Etikës”, me qëllim përdorimin eficient të burimeve financiare dhe administrative në përmbushjen e funksioneve të Autoritetit;
- f) **Shfuqizohet;**
- g) **IIA** është organizmi ndërkombëtar i quajtur Instituti i Audituesve të Brendshëm, përgjegjës për shpalljen e përkufizimit, standardeve ndërkombëtare dhe kodit të etikës të auditimit të brendshëm.

Neni 4 **Statusi organizativ**

Njësia e auditimit të brendshëm është pjesë përbërëse e strukturës organizative të Autoritetit, e pavarur nga veprimtaria e përditshme e tij.

Neni 5 **Misioni**

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të pavarur dhe të arsyeshme dhe të ofrojë shërbime këshillimi, për t'i shtuar vlerë Autoritetit dhe për të përmirësuar veprimtarinë dhe sistemet e kontroleve të brendshme të Autoritetit.

Çdo angazhim auditimi kryhet në përputhje me aktet ligjore nënligjore në fuqi, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar dhe shpallura nga ministri përgjegjës për financat, të planit të konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Autoritet.

Auditimi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë së tyre, nëpërmjet analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve dhe rekomandimeve, lidhur me veprimet e ekzaminuara.

Neni 6

Qëllimi i auditimit të brendshëm

Qëllimi i auditimit të brendshëm është të ndihmojë drejtimin e Autoritetit të arrijë objektivat dhe të përmbushë me efektivitet përgjegjësitë e veta, duke përdorur një metodë sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe përmirësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut, e proceseve të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet duke respektuar përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Këto udhëzues, përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontroleve të brendshme dhe performancës së veprimtarisë audituese. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do t'i përmbahet edhe politikave, procedurave metodave të auditimit, si pjesë e manualit standard të auditimit të brendshëm.

Neni 7

Objekti i auditimit të brendshëm

1. Auditimi i brendshëm përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e aktiviteteve, operacioneve, proceseve, politikave, procedurave dhe sistemeve të Autoritetit për të siguruar:

- a) Besueshmëri dhe integritet të informacionit;
- b) Pajtueshmëri me politikën, planet, procedurat, ligjet dhe rregullat;
- c) Ruajtje të aktiveve;
- d) Përdorim ekonomik dhe efikas të burimeve; dhe
- e) Përmbushje të objektivave dhe qëllimeve të vendosura në lidhje me veprimtaritë ose programet e Autoritetit.

2. Auditimi i brendshëm ofron shërbime këshillimi për Autoritetin për çështje që lidhen me kontrollet e brendshme, hetimet speciale dhe fusha të tjera që paraqesin interes apo shqetësim, vetëm me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv ose të Bordit.

Neni 8

Përgjegjshmëria

Njësia e auditimit të brendshëm në përmbushjen e detyrave të veta, përgjigjet tek drejtimi i Autoritetit. Njësia e auditimit të brendshëm:

- a) Paraqet në Bord dhe tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vlerësime për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm, administrimit të rreziqeve dhe proceseve të qeverisjes;
- b) Paraqet në Bord dhe tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me angazhimet e kryera të auditimit;
- c) Raporton në Bord një herë në vit për ecurinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, përmbushjen e planit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Neni 9

Përgjegjësitë

1. Njësia e auditimit të brendshëm kryen angazhimet e auditimit, të përcaktuara në planin vjetor të auditimit, të miratuar nga Bordi. Plani mund të ndryshohet me kërkesë të Bordit ose të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv ose me propozim të Përgjegjësit të njësisë së auditimit të brendshëm.

Përcaktimi i sistemeve/fushave që do të mbulohen me auditim duhet të jetë gjithëpërfshirës për të mundësuar ekzaminimin efektiv dhe të rregullt të të gjithë veprimtarive operacionale, financiare dhe të lidhura. Për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara të Autoritetit do të vlerësohet përshtatshmëria dhe efektiviteti i qeverisjes, rrezikut të menaxhimit të njësisë dhe kontroleve të brendshme, si dhe cilësia e performancës për kryerjen e përgjegjësiave të caktuara.

2. Njësia e auditimit të brendshëm ka këto detyra:

- a) Përgatit planin vjetor të auditimit duke përdorur metodën e bazuar në rrezik dhe e dërgon për miratim në Bord. Plani i miratuar i njoftohet drejtorëve të departamenteve dhe drejtorive;
- b) Zbaton planin vjetor të auditimit duke planifikuar dhe kryer angazhimet e auditimit dhe detyrat e këshillimit;
- c) Komunikon rezultatet e angazhimeve të auditimit dhe detyrave të këshillimit në Bord të paktën 3 (tre) herë në vit dhe te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv në përfundim të çdo detyre;
- d) Ndjek dhe vlerëson zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- e) Auditon strukturat, programet dhe veprimtaritë e Autoritetit, për të përcaktuar nëse ato kryejnë në mënyrë efikase dhe efektive funksionet e tyre të planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit, në përputhje me udhëzimet, politikat dhe procedurat e vendosura për arritjen e objektivave të Autoritetit;
- f) Vlerëson mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të vendosura të kontrollit të brendshëm dhe jep rekomandime për përmirësimin e tyre;
- g) Vlerëson pajtueshmërinë me ligjet dhe me rregullat, mbi bazën e të cilave është organizuar veprimtaria e Autoritetit;
- h) Shqyrton aktivitetin financiar dhe vlerëson besueshmërinë e informacionit financiar si dhe mjeteve të përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar dhe raportuar këtë informacion;

- i) Vlerëson masat për ruajtjen e aktiveve dhe verifikon ekzistencën fizike të tyre, kur gjykohet e nevojshme;
- j) Bashkërendon punën e Autoritetit me audituesin e jashtëm, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave;
- k) Propozon kontraktimin e shërbimit të auditimit për aktivitete specifike të Autoritetit dhe drejton procesin e auditimit.

Neni 10

Pavarësia

Njësia e auditimit të brendshëm është në varësi të Bordit dhe të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. Cenimi i pavarësisë ose i paanshmërisë, realisht ose në dukje, i njësisë së auditimit të brendshëm, raportohet në nivelet përkatëse të drejtimit të Autoritetit. Veprimtaria e auditimit të brendshëm është e lirë nga ndërhyrjet në lidhje me çështjet e zgjedhjes së auditimit, fushëveprimin, procedurat, frekuencën, kohën, apo përmbajtjen e raportit, të cilat lejojnë mbajtjen e një qëndrimi të nevojshëm të pavarur dhe objektiv.

Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka përgjegjësi për zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja, por mund të japë këshillime. Njësia e auditimit të brendshëm shfaq nivelin më të lartë të objektivitetit profesional në grumbullimin, vlerësimin, dhe komunikimin e informacionit në lidhje me aktivitetin ose procesin, që janë duke shqyrtuar. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të bëjë vlerësim të balancuar të të gjitha sistemeve/fushave që auditohen dhe nuk ndikohet nga interesat e tyre, ose nga të tjerët në formimin e gjykimeve.

Neni 11

Detyrat

1. Njësia e auditimit të brendshëm, në përmbushje të përgjegjësisë të veta, autorizohet:
 - a) Të shqyrtojë të gjitha veprimtaritë dhe informacionet e Autoritetit;
 - b) Të ketë të drejta hyrjeje dhe përdorimi të plotë dhe të pakufizuar tek të gjitha veprimtaritë, regjistrimet, informacionet (*records*), sistemet, pronat dhe punonjësit e Autoritetit;
 - c) Të shpërndajë burimet, të vendosë mbi shpeshtësinë, të përzgjedhë temat, të përcaktojë objektin e punës dhe të zbatojë teknikat e kërkuara për të realizuar objektivat, në mënyrë të pavarur;
 - d) Të ushtrojë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit;
 - e) Të kërkojë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për njësinë që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi. Njësitë e audituara japin informacionin e kërkuar në mënyrë të plotë dhe të vërtetë brenda një kohe të arsyeshme, që nuk pengon procesin e auditimit;

- f) Të marrë nga punonjësit e njësisë së audituar, për rastet që gjykohej e nevojshme, shpjegime, deklarata dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i njësisë të audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të njësisë;
 - g) T’i paraqesë kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit ose Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmojnë se për shkaqe të argumentuara cenohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit;
 - h) T’i ofrohet asistencë dhe bashkëpunimi i nevojshëm nga personeli i njësisë që auditohet gjatë zhvillimit të veprimtarisë së auditimit, si dhe shërbime të tjera të specializuara nga brenda ose jashtë njësisë që auditohet;
 - i) Të gjithë punonjësit e Autoritetit duhet të bashkëpunojnë për të ndihmuar njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e misionit, rolit dhe përgjegjësi të saj. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të ketë akses të lirë dhe të pakufizuar edhe tek Bordi i AMF-së.
2. Përgjegjësi i njësisë së auditimit të brendshëm njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv për përpjekjet për të fshehur ose mbajtur informacionin e kërkuar nga njësitë e audituara ose për ta penguar atë në ushtrimin e përgjegjësi të veta. Në rast se kjo çështje nuk gjen zgjidhje, Përgjegjësi i njësisë së auditimit të brendshëm njofton Bordin.
3. Njësia e auditimit të brendshëm, në përmbushje të përgjegjësi të veta, nuk autorizohet:
- a) Të kryejë ose të drejtojë drejtpërdrejt ndonjë veprim ose operacion të cilin e auditon;
 - b) Të hartojë dhe të vendosë procedura, të nxjerrë urdhra e udhëzime, të përgatisë dokumente dhe informacione, ose të përfshihet në veprimtari që normalisht do të auditohen;
 - c) Të vijë në ndihmë në çdo lloj forme punonjësve të tjerë për përgjegjësi që u janë caktuar atyre;
 - d) Të auditojë veprime ose operacione për të cilat kanë qenë përgjegjës në 12 muajt e fundit.
- Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe specialistët auditues ndalohen të mbajnë mandat politik apo të jenë të zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike.
4. Njësia e auditimit të brendshëm, mund të angazhohet në veprime operacionale të Autoritetit në rrethana të jashtëzakonshme me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv ose të Bordit. Në këtë rast Autoriteti pranon se angazhimi nuk rrezikon pavarësinë e auditimit të brendshëm dhe asnjë pengesë apo cenim nuk do të pasojë si rrjedhojë e kësaj rrethane.
5. Njësia e auditimit të brendshëm, mund të angazhohet në shërbime këshillimi për programe, projekte, apo fusha të tjera që paraqesin interes ose shqetësim. Në të tilla angazhime Autoriteti pranon se veprimi nuk rrezikon pavarësinë e auditimit të brendshëm. Urdhri i angazhimit përcakton me detaje detyrat, përgjegjësitë dhe produktin e punës së audituesit të brendshëm.

Neni 12

Integriteti

Audituesi i brendshëm në veprimtarinë e vet zbaton kodin e etikës dhe:

- a) Siguron paanshmëri dhe pavarësi, vepron pa konflikt interesi si në fakt edhe në dukje;
- b) Përbush përgjegjësitë e veta duke ushtruar kujdesin e duhur profesional, kompetencë dhe zell në përputhje me standardet e profesionit;
- c) Përpiqet për të përmirësuar aftësitë dhe cilësitë e shërbimit nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe përvojës;
- d) Ndërmerr ato lloj përgjegjësisë që përputhen me aftësitë dhe me rolin profesional.

Neni 13

Standardet e praktikave të auditimit

Veprimtaria e auditimit të brendshëm zhvillohet në pajtim me standardet ndërkombëtare të shpallura nga IIA për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, përfshi Kodin e Etikës të IIA.

Neni 14

Organizimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm

Përgjegjësi i njësisë së auditimit do të raportojë tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Bordi, i cili do të miratojë:

- a) Kartën (statuti) e auditimit të brendshëm;
- b) Planet e auditimit të brendshëm vjetor dhe strategjik;
- c) Buxhetin dhe burimet e auditimit;
- d) Performancën e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm dhe çështje të tjera;
- e) Kryerjen e veprimeve me natyrë investiguese, mbi veprimtaritë e rëndësishme brenda Autoritetit të dyshuara për mashtrim dhe për këtë drejtuesi të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Bordin e AMF-së.

Përgjegjësi i njësisë së auditimit do të komunikojë dhe ndërveprojë direkt me Bordin e AMF-së, duke përfshirë në seancat ekzekutive dhe në mes të mbledhjeve të Bordit diskutimet për çështjet sipas nevojës, dhe ato më me interes.

Neni 14/1

Raportimi dhe monitorimi

Një raport i shkruar do të përgatitet dhe lëshohet nga përgjegjësi i njësisë së auditimit, në përfundim të auditimeve dhe rezultatet e tij do të shpërndahen në funksion të qëllimit.

Rezultatet e auditimit të brendshëm duhet t'i komunikohen edhe Bordit të AMF-së.

Raporti i auditimit të brendshëm mund të përfshijë përgjigjet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra nga menaxhimi ose që do të merren në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet specifike dhe janë konfidenciale për palët e treta që nuk përfshihen në raport.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të jetë përgjegjëse për të gjitha gjetjet e angazhimit dhe zbatimin e rekomandimeve. Të gjitha gjetjet e rëndësishme do të mbahen në një skedar si çështje të hapura deri sa ato të zbatohen plotësisht.

Përgjegjësi i njësisë së auditimit do të raportojë periodikisht për Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Bordin e AMF-së, mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm qëllimin, autoritetin, përgjegjësitë, si dhe performancën e saj. Raportimi do të përfshijë ekspozimet ndaj rreziqeve dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë edhe rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Bordin e AMF-së.

Neni 14/2

Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të mbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit që mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm. Programi do të përfshijë një vlerësim të përputhshmërisë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Standardet dhe Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Përgjegjësi i njësisë së auditimit të brendshëm do të komunikojë me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Bordin, lidhur me implementimin dhe sigurimin e cilësisë dhe programit të përmirësimit, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit e vazhdueshme të brendshme dhe vlerësime të jashtme, të cilat duhet të kryhen të paktën në çdo 5 (pesë) vjet.

Neni 15

Dispozita të fundit

Nenet 12, 13 dhe 14 të Rregullores “Rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 30.08.2007, shfuqizohen.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.